



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA DURRËS**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr. 96, datë 29.09.2022

**PËR**  
**MIRATIMIN E MANDATIT TË ANËTARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK**  
**Z. VALTER ABAZ HOXHA**

Në mbështetje të nenit 113, pika 1 dhe 2, të Pjesës së Gjashtë “Qeverisja Vendore” e ligjit nr.8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” e ndryshuar, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, gërma “b”, nenit 49, pika 1 dhe pika 2, nenit 50, nenit 54, pika “j”, nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, të Rregullores së Funksiomit të Këshillit Bashkiak, shkresës të Komisionit Qëndror Zgjedhor me nr.prot. 3184, datë 15.09.2022, mbështetur në raportin e Komisionit të Mandateve si dhe pas betimit në Këshillin Bashkiak Durrës, në mbledhjen e datës 29.09.2022,

**KËSHILLI BASHKIAK**  
**V E N D O S I :**

1. Miratimin e mandatit të anëtarit të Këshillit Bashkiak Durrës, kandidat në listën shumëmemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë z. Valter Abaz Hoxha.
2. Z. Valter Abaz Hoxha emërohet në Komisionin e Politikave të Zhvillimit të Turizmit me detyrë anëtar si zëvendësues i z.Elio Jani. Ndërsa në Komisionin e Strehimit dhe Shërbimeve Publike do të emërohet si anëtar këshilltari z. Indrit Cërloj.

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Sekretari Këshillit Bashkiak.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

**KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ani Dyrmishi**



**U shpall sot me datë 29.09.2022**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 776/1 prot.

Durrës, më 07.10.2022

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK  
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË  
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.96 datë 29.09.2022

“Për miratimin e mandatit të anëtarit të Këshillit Bashkiak Z.Valter Abaz Hoxha”

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI  
EMILJAN JANI**

